

STATUTI  
I SHOQERISE PRIVATE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
NOVA SOLAR SYSTEM L&V SH.P.K.

Sot, me datë 19.09.2023, themeluesit Valentinë Marku dhe Leonart Prenga, kanë krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **NOVA SOLAR SYSTEM L&V SH.P.K.** dhe me vullnetin e tyre të lire dhe të plotë miratojnë statutin e shoqërisë **NOVA SOLAR SYSTEM L&V SH.P.K.** me parimet e tij si më poshtë:

KREU I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

NENI 1

1.1 Themeluesit e shoqërisë janë:

- Valentinë Dedë Marku, e datëlindjes **18.03.1984**, shtetase shqiptare, lindur në Shkodër, Shqipëri dhe banues në Rruga Mark Matushaj 03500048; Nd. 3; H. 1; ; Velipojë; Pulaj; 4020; Shkodër, e cila identifikohet me karte identiteti me numër personal I45318122T.
- Leonart Bibë Prenga, i datëlindjes 07.08.1979, shtetas shqiptar lindur ne Vig, Shkodër, banues në Lagjen Pulaj, Rruga nr.4, zona Kadastrale 3072, Velipojë, Shkodër i cili indentifikohet me karte identiteti me numër personal H90807105G.

NENI 2

FORMA DHE EMRI

2.1 Shoqëria ka formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale **SH.P.K.**, të cilat vijnë përpara ose menjëherë pas emrit të shoqërisë. Kjo shoqëri i përballon humbjet deri në kufirin maksimal të vlerës së kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërisë.

2.2 Emri i shoqërisë është **NOVA SOLAR SYSTEM L&V SH.P.K.**, Forma dhe emri i shoqërisë mund të ndryshohen me vendim të asamblesë së përgjithshme të ortakëve.

2.3 Emri tregtar i shoqërisë NOVA SOLAR SYSTEM L&V do të përdoret për reklamimin e produkteve së bashku me emrin ligjor te subjektit **NOVA SOLAR SYSTEM L&V SH.P.K.**

NENI 3

BAZA LIGJORE

3.1 Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me Ligjin Nr. 9723,

datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” dhe Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”, në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë, si dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe që do të ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

#### NENI 4 SELIA

4.1 Selia e shoqërisë është në adresën **Pulaj- Plazh, Rruga Nr 3, godine 4- kateshe, kati i parë, nr 1, Velipoje 4020, SHKODER.** Me adresën e mësipërme do të identifikohet selia e shoqërisë. Me vendim të asamblesë së ortakut mund të hapen degë, filiale, agjenci ose përfaqësi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas fushave në të cilat e ushtron veprimtarinë shoqëria.

4.2 Adresa e shoqërisë për qëllime të komunikimit elektronik është:

**markuvalentina1@gmail.com**

4.3 Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj lirisht si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

4.4 Shoqëria mund të krijojë zyra ose përfaqësi të saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Zyra, Filiale ose përfaqësitë e shoqërisë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të krijohen dhe do të zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

#### NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISE

5. Shoqëria **NOVA SOLAR SYSTEM L&V SH.P.K.**, është e organizuar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar për të ushtruar aktivitetin në fushën e: Prodhimit të Energjisë Fotovoltaike, Hidrike, Solare etj, Shit-Blerje Energjie Fotovoltaike, Solare, Hidrike, montim të paneleve që prodhojnë energji të rinovueshme. Import Eksport për materialeve të ndryshme dhe transportin e tyre. Aplikimi dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Institucionet e Shtetit Shqiptar i të gjitha lejeve dhe licencave të cilat mundësojnë zhvillimin e këtij aktiviteti në përputhje me kuadrin ligjor në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë cdo lloj aktiviteti të parashikuar nga ligji në përputhje me rregullat e dispozitat në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në bazë të autorizimeve dhe/ose lejeve përkatëse të lëshuara nga organet kompetente të fushës, etj.

#### NENI 6 KOHEZGJATJA

6.1 Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat të **papërcaktuar në kohë**, duke filluar nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar. Shoqëria priset dhe kalon në procedure likuidimit me vendim të asamblesë së ortakeve, si dhe në rastet e tjera të parashikuara në ligj.

KREU II  
KAPITALI  
NEN 7  
KAPITALI THEMELTAR

7.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 Leke (njëqindmijë lekë). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të përcaktuara në pikën 7.2 të këtij neni.

7.2 Ortakët themelues janë

- Valentinë Dedë Marku: zotërues i 1(Një) kuote me vlerë të përgjithshme 50,000 lek (pesëdhjetëmijë lek), që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Leonart Bibë Prenga; zotërues i 1(Një) kuote me vlerë të përgjithshme 50,000 lek (pesëdhjetëmijë lek), që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Kapitali themeltar i shoqërisë është shlyer tërësisht dhe depozituar në një llogari të hapur në emër të shoqërisë në një nga bankat e nivelit të dyte.

NENI 8  
ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

8.1 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërisë kryhet sipas vendimit të asamblesë së përgjithshme të ortakeve, me shumicën e (tre të katërtave) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë.

8.2 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

8.3 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin e shoqërisë.

8.4 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në po atë masë sa është pjesëve të kapitalit që ato përfaqësojnë.

8.5 Përgjegjësia e ortakëve për detyrimet e shoqërisë shtrihet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e saj themeltar.

NENI 9  
TRANSFERIMI I KAPITALIT

9.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë NOVA SOLAR SYSTEM L&V shoqëri me përgjegjësi të

kufizuar dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shitblerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

9.2 Transferimi i kapitalit themeltar të shoqërisë ose i pjesëve të tij tek persona të tretë bëhet vetëm në këtë mënyrë:

- Oferta për shitje u drejtohet të gjithë ortakëve me shkrim;
- Oferta duhet të përcaktoje numrin e kuotave që shiten dhe çmimin e tyre;

Nëse ortakët e shoqërisë brenda tre muajsh nga oferta me shkrim nuk pranojnë blerjen e kuotave të ofruara me çmimin e kërkuar, atëherë ata konsiderohet se lejojnë shitblerjen tek të tretët.

9.3 Kapitali themeltar është lirisht i trashëgueshëm në rrugë trashëgimie. Bashkëshorti, paraardhësit mund të bëhen ortakë nëpërmjet transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar sipas kushteve që lejohen në ligj.

9.4 Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund të rëndohen lirisht me barrë siguroese apo të drejta të tjera reale. Në rast shitje të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë për efekt zbatimi të një vendimi gjyqësor apo përmbushje të një detyrimi, enti që ekzekuton vendimin ose detyrimin (zyra përmbartimore ose ndonjë organ tjetër kompetent), duhet të këtë në konsideratë respektimin e kërkesave të nenit 9 të këtij statuti. Secili ortak që rëndon me barrë apo të drejta të tjera reale kuotat e tij, ka detyrimin ti shpjegoje nenin 9 të këtij statuti subjektit në favor të cilit vendoset barra siguroese.

9.5 Secili ortak ushtron të drejtat pasurore të parashikuara nga ligji në proporcion me kuotat e pjesëmarrjes në kapital.

9.6 Ortakët që nuk marrin pjese në administrimin e shoqërisë kanë të drejtë t'i kërkojnë organit administrativ informacione mbi aktivitetin e shoqërisë, si dhe të konsultojnë dokumentet kontabël e dokumentet e tjera që lidhen me administrimin e saj.

## NENI 10 FINANCIMI I SHOQERISE

10.1 Organi administrativ, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ka të drejtë të kërkojë nga ortaket fondet e nevojshme për arritjen e objektit të shoqërisë.

10.2 Financimet e mëtejshme të ortakeve do të jenë me shpërbllim (interesa) apo pa shpërbllim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit jepen këto fonde.

## KREU III ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

### NENI 11 ORGANI VENDIMMARRËS

11.1 Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë, që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të parashikuara në ligj.

11.2 Asambleja e ortakëve vendos për çështjet që ligji apo ky statut ia rezervon këtij organi, si dhe për çështjet për të cilat, organi administrativ kërkon mendimin apo miratimin e ortakëve.

11.3 Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimin e statutit;
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar/audituesve ligjorë;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji dhe statuti.

11.4 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo ndonjë person i tretë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## NENI 12

### MENYRA DHE VENDI I THIRRJES SE ASAMBLESE SE ORTAKEVE

12.1 Asambleja e ortakëve thirret pranë selisë së shoqërisë, apo në ndonjë vend tjetër brenda apo jashtë Shqipërisë, nëpërmjet një njoftimi me shkrim që iu dërgohet ortakëve nga kryetari i asamblesë së ortakëve dhe/ose organi administrativ.

12.2 Njoftimi i thirrjes së mbledhjes së asamblesë duhet të kryhet 7 (shtatë) ditë përpara datës së mbledhjes dhe duhet të përcaktojë shprehimisht datën, orën, vendin si dhe rendin e ditës.

12.3 Në rast pamundësie apo mosveprimi nga ana e organit administrativ, mbledhja e asamblesë së ortakëve mund të thirret nga eksperti kontabël i autorizuar, nëse ka të tillë, ose nga një apo më shumë ortakë, të cilët përfaqësojnë jo më pak se 10% të

kapitalit të shoqërisë.

### NENI 13 KONSULTIMI ME SHKRIM I ORTAKEVE

13.1 Në përputhje me dispozitat e statutit, vendimet e ortakëve mund të merren pas një konsultimi me shkrim që organi administrativ i drejton secilit prej tyre. Në këtë rast, organi administrativ i komunikon ortakëve tekstin e projekt-vendimit që do të merret dhe i kërkon të shprehin vullnetin e tyre në lidhje me këtë çështje.

13.2 Vendimet e marra në këtë mënyrë janë të vlefshme kur vendimi merret nga shumica që ligji apo ky statut kërkon për atë çështje.

### NENI 14 KRYETARI I MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE ORTAKEVE

14.1 Mbledhja e asamblesë së ortakëve emëron kryetarin e asamblesë.

14.2 Kryetari i asamblesë verifikon thirrjen dhe mbledhjen e rregullt të asamblesë së ortakëve, vërteton identitetin apo legjitimitimin e përfaqësuesit të ortakëve dhe drejton zhvillimin e rregullt të mbledhjes.

### NENI 15 KOURUMI

15.1 Çdo ortak ka të drejtën e një vote për çdo kuotë të kapitalit themeltar të shoqërisë që ai zotëron.

15.2 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

15.3 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

15.4 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### NENI 16 MARRJA E VENDIMEVE

16.1 Asambleja e përgjithshme vendos me 3/4 (tri të katërtat) e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës:

- për ndryshimin e statutit;
- zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- shpërndarjen e fitimeve;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

16.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertin kontabël të autorizuar/auditues ligjor, duke përcaktuar dhe detajuar kompetencat e tyre, të drejtat, detyrimet, kohëzgjatjen në detyrë, dhe shpërblimin e tyre;
- përcaktimin e shpërblimeve;
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecures së veprimtarisë;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

16.3 Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet në regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

16.4 Për çfarë nuk është pasqyruar në këtë nen, asambleja e ortakëve të shoqërisë vendos në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14. 04. 2008, i ndryshuar.

## NENI 17 PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS

17.1 Ortaku nuk mund ta ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- Vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- Ngritjen e një padije ndaj tij nga shoqëria;
- Dhënien ose jo të përfitimeve të reja;

17.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashti si dhe ortaku, të cilin e përfaqëson.

## NENI 18 ADMINISTRIMI

18.1 asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizik si administratorë të shoqërisë. Termi "Administrator" përdoret për të përcaktuar administratorin e shoqërisë **NOVA SOLAR SYSTEM L&V SH.P.K.**, ky term nënkupton të

gjithë administratorët e saj sado qoftë numri i tyre. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

18.2 administratorët e një shoqërie mëmë, sipas përcaktimeve të bënit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

18.3 Personi i caktuar si administrator i shoqërisë NOVA SOLAR SYSTEM L&V SHPK për një periudhë 5 (pesë) vjeçare është: **VALENTINË MARKU**, atësia Dedë, i datëlindjes 18.03.1984, shtetase shqiptare, e cila identifikohet me karte identiteti me numër personal I45318122T, lindur në Shkodër, Shqipëri dhe banues me adrese në Rruga Mark Matushaj, 03500048; Nd. 3; H. 1; ; Velipojë; Pulaj; 4020; Shkodër.

#### NENI 19

#### ADMINISTRATORI DHE KOMPETENCAT E TIJ

19.1 Kompetencat e administratorit ose të administratoreve, në mënyrë konkrete dhe të detajuar përcaktohen në aktin e tyre të emërimit. Veç të tjerave që mund të detajohen në këtë akt, administratori ka edhe këto kompetenca:

- kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- krijojnë sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Kujdeset për funksionimin e përditshëm normal të shoqërisë ose të një pjese të aktivitetit ekonomik dhe financiar të saj, sipas përcaktimit në aktin e emërimit.
- përgatit dokumentacionin dhe raportet e ndryshme për gjendjen ekonomike dhe financiare të shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi dhe ia paraqet asamblesë së ortakëve për shqyrtim.
- rregullojnë veprimtarinë e personave të punësuar në shoqëri, në përputhje me Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë.
- ndjek problemet e shoqërisë në marrëdhënie me organet shtetërore ose cakton ndonjë prej personelit për trajtimin e këtyre problemeve.
- i propozon asamblesë së ortakëve tarifatat e shërbimeve dhe pagat për personelin e punësuar në shoqëri.



- i propozon asamblesë së ortakëve rregulloren e shoqërisë.

19.2 Administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton se ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të madhe se 5 për qind e aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- Shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerën më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

19.3 Administratorët kanë të drejtë të gjithë së bashku ose veçmas nga njeri tjetri të përfaqësojnë shoqërinë në lidhje me të tretët.

19.4 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## NENI 20

### PËRGJEGJESITË E ADMINISTRATORIT

20.1 Administratori ose administratorët janë përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj palëve të treta qoftë për shkelje ligjore, qoftë për shkelje të statutit ose për faje të kryera gjatë ushtrimit të administrimit të shoqërisë. Përgjegjësia është individuale ose solidare, kjo në varësi të rrethanave dhe të mënyrës sesi është vepruar, pra individualisht ose të gjithë së bashku.

20.2 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të këtij ligji, administratorët detyrohen:

- a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- d) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji;
- dh) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

20.3 Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë

tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

20.4 Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

20.5 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:

- a) u kthejnë ortakëve kontributet;
- b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndajnë aktivet shoqërisë;
- ç) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) japin kredi.

20.6 Dispozitat e pikës 6 të nenit 92 të këtij ligji zbatohen edhe për paditë, që rrjedhin nga paragrafët e këtij neni. Këto padi duhet të ngrihen brenda 3 vjetëve nga kryerja e shkeljes apo nga zbulimi i saj.

## KAPITULLI IV VITI FINANCIAR - EKSPERTET

### NENI 21

#### VITI FINANCIAR

21.1 Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 janar dhe përfundon me 31 dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

### NENI 22 KONTROLLI KONTABEL

22.1 Kontrolli i jashtëm kontabël i shoqërisë kryhet nga ekspertë kontabël të autorizuar/auditues ligjorë, sipas legjislacionit në fuqi. Asambleja e ortakëve do të emërojë një apo më shumë eksperte kontabël në ato raste kur emërimi i tyre

konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

### NENI 23 LIBRAT E SHOQERISE

23.1 Shoqëria është e detyruar të mbaje, përveç librit të shoqërisë, në të cilin shënohen emrat e plotë të ortakëve dhe kapitali themeltar, vendimet e asamblesë së ortakëve, regjistrin e pronarëve përfitues, si edhe dokumentacionin kontabël dhe librat e tjerë.

### NENI 24 BILANCI DHE REZERVAT

24.1 Bilanci mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti. Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiare dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël i autorizuar, i paraqiten për shqyrtim asamblesë së ortakëve, e cila vendos mbi miratimin, ndryshimin ose rrëzimin e këtyre akteve, kur e konsideron te nevojshme asambleja e ortakëve mund të beje rekomandimet e nevojshme në lidhje me çështjen në diskutim.

24.2 Me mbylljen e secilit vit financiar, administratori i vetëm merr masat e nevojshme për hartimin e projekt-bilancit të aktivitetit për vitin financiar të mbyllur, në mënyrë që asambleja e ortakëve të vendosë mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme të tij brenda afateve të përcaktuara nga ligji.

24.3 Asambleja e ortakëve vendos mbi ndarjen ndërmjet ortakëve të shumave që rezultojnë si fitime sipas bilancit të aprovuar rregullisht, pasi nga këto shuma të jenë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme, si dhe të jenë lënë mënjanë shumat e nevojshme për krijimin e rezervës ligjore. Rezerva ligjore krijohet vit pas viti nëpërmjet lënies mënjanë të një shume të barabarte me 5 % të fitimit neto të realizuar gjatë secilit vit financiar, deri sa të arrihet një shume e barabartë me 10 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

24.4 Asambleja e ortakëve në çdo moment mund të vendosë krijimin e rezervave të tjera, si dhe masën e tyre.

### KAPITULLI V MBARIMI DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

#### NENI 25 MBARIMI

Shoqëria mbaron me vendim të asamblesë së jashtëzakonshme të ortakëve ose kur ka një prishje të parakohshme për arsyet e parashikuara në ligj.

#### NENI 26 LIKUJDIMI

26.1 Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për

kryerjen e këtij procesi asambleja e ortakeve cakton një ose disa likuidues, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

26.2 Në fund të procesit të likuidimit, asambleja e ortakeve vendos mbi bilancin përfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procedurës së likuidimit.

26.3 Mbas pagimit të kreditorëve asambleja e ortakeve mban pjesën e mbetur të kapitalit që u shpërndahet ortakeve.

## KAPITULLI VI

### MOSMARRËVESHJET DHE DISPOZITA TE FUNDIT

#### NENI 27

#### ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

27.1 Çdo mosmarrëveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do të angazhohen se do ta zgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet gjykata kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve apo konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata Shqiptare.

#### NENI 28

#### DISPOZITA TE FUNDIT

28.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, do të aplikohen dispozitat e legjislacionit shqiptarë në fushën e shoqërive tregtare si dhe legjislacioni shqiptar në përgjithësi.


28.2 Ky statut është hartuar në 3 (tre) ekzemplare, në gjuhën shqipe, duke patur secili ekzemplar fuqi të njëjtë ligjore.

**28.3 Ngarkohet administratorja e shoqërisë Valentinë Marku me ID I45318122T, të kryejë aplikimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë në regjistrin tregtar dhe në regjistrin e pronarë përfitues në përputhje me legjislacionin në fuqi.**

### ORTAKËT E SHOQËRISE NOVA SOLAR SYSTEM L&V SH.P.K.

VALENTINË MARKU

LEONART PRENGA





Shkodër 19.09.2023

